

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Halil Asllani

**NDIKIMI I TEKNOLOGJISË NË ZHVILLIMIN E
KOMPETENCËS LEXIMORE NË GJUHËN E DYTË NË
ARSIMIN E MESËM NË KOSOVË**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2021

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"
FACULTY OF PHILOLOGY

Halil Asllani

**THE IMPACT OF TECHNOLOGY ON THE
DEVELOPMENT OF SECOND LANGUAGE READING
COMPETENCY AT SECONDARY EDUCATION IN
KOSOVO**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Halil Asllani

**NDIKIMI I TEKNOLOGJISË NË ZHVILLIMIN E
KOMPETENCËS LEXIMORE NË GJUHËN E DYTË NË
ARSIMIN E MESËM NË KOSOVË**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori:
Prof. asoc. dr. Rrahman Paçarizi

Prishtinë, 2021

REZYME

Mësimdhënia dhe mësimnxënia e gjuhëve në përgjithësi dhe e gjuhës së dytë në veçanti, kanë qenë objekt trajtimi e studimi në vazhdimësi, sidomos nga pjesa e dytë e shekullit të njëzetë kur lëvizja e madhe e njerëzve ngriti nevojën e mësimin të gjuhëve të huaja. Ritmi i shpejtë i proceseve globalizuese dhe zhvillimet e hovshme teknologjike, së bashku me ndikimin gjithnjë në rritje të anglishtes si një *lingua franca*, kanë zgjuar interesim të shtuar për studime dhe hulumtime në mësimdhënie dhe mësimnxënie të gjuhës së dytë/huaj (Hinkel, 2011). Gjithashtu, rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në ambiente shkollore dhe shtëpiake ka përhapur në masë të madhe mundësitë e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie të gjuhës së dytë (Hubbard dhe Levy, 2006). Këto zhvillime kanë sjellë në diskursin shkencor togfjalëshin gjuha dhe teknologjia, i cili tashmë ka zënë një vend të rëndësishëm si fushë tërheqëse studimi e kërkimi. Rrjedhimisht, në dritën e këtyre zhvillimeve, ndërmarrja e këtij studimi doktoral në këtë lëmë specifik të dijes, në një kontekst socio-kulturor unik, paraqet një kontribut sa modest aq edhe të rëndësishëm, gjithnjë në përpjekje për të gjetur qasje dhe metoda sa më efektive në funksion të zhvillimit të shkathtësive respektive gjuhësore.

Rrjedhimisht, në dritën e këtyre zhvillimeve dhe si kërkesë dhe si nevojë e kohës, që ideuar edhe ky studim doktoral i cili synim kryesor kishte hetimin e zhvillimit të kompetencës leximore, respektivisht të të kuptuarit e të lexuarit dhe të mësimin rastësor të vokabularit në gjuhën e dytë (angleze) në dy ambiente të ndryshme të mësimdhënies/mësimnxënies, respektivisht në klasën tradicionale dhe në atë teknologjike. Zhvillimi i kompetencës leximore në gjuhën e dytë zë një vend qendror në fushën e SLA-së (ang. Second Language Acquisition) dhe është një komponent sa rëndësishëm, aq edhe kompleks. Që nga fillimet e para në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të njëzetë, SLA-ja ka synuar të hulumtojë dhe dokumentojë mënyrën se si fëmijët dhe të rriturit e mësojnë gjuhën e dytë, duke u fokusuar në aspekte të ndryshme gjuhësore, kognitive, sociale, kontekstuale, dhe psikologjike (Abbhul dhe Mackey 2008). Me daljen në skenë të CALL-it (ang. Computer Assisted Language Learning) është paraqitur nevoja për hulumtimin dhe studimin e kompetencës leximore dhe të mësimin të vokabularit në gjuhën e dytë në një ambient dhe format tjetër. Leximi dhe teknologjia, sipas Grabe-it (2009, f. 383), është një fushë komplekse që po gëzon zhvillim të shpejtë në tri drejtime kryesore: “(a) roli i kompjuterit, softuerëve mësimorë dhe i burimeve të tjera teknologjike për mësimin e leximit me ndihmën e teknologjisë; (b) rritja e

teksteve elektronike dhe multimediale dhe leximi e të kuptuarit të tyre; (c) efikasiteti i mësimdhënies së shkathtësisë leximore me anë të mjeteve teknologjike”. Andaj, në linjë me thirrjet e komunitetit shkencor dhe me trendet e zhvillimit të fushës në njërin anë, si dhe perceptimet e vërejtjet e akumuluar ndë vite për sfidat dhe problemet e paraqitura gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies së anglishtes si gjuhë e dytë, me fokus në kompetencën leximore dhe të nxënies së vokabularit në anën tjetër, doli në dritë ky punim doktoral.

Në mënyrë më specifike, hulumtimi synoi të gjente nëse zhvillohen në mënyrë të barabartë të kuptuarit e të lexuarit dhe mësimi rastësor i vokabularit në gjuhën e dytë në dy ambiente të ndryshme të mësimdhënies/mësimnxënies, pra në klasën tradicionale dhe ambientin digjital/teknologjik. Po ashtu, qëllim kryesor ishte gjetja e formës, respektivisht modalitetit më efikas të anotimit hipermedial në funksion të përmirësimit të të kuptuarit e të lexuarit dhe të mësimi rastësor të vokabularit. Njëkohësisht, u hetua nëse ambientet digjitale të mësimdhënies/mësimnxënies janë motivuese për zhvillimin e këtyre shkathtësive gjuhësore. Për të arritur këto qëllime u formuan katër grupe nxënësish pesëmbëdhjetëvjeçar në një shkollë të arsimit të mesëm në Kosovë. Një klasë nxënësish formuan grupin e kontrollit dhe tri klasat e tjera formuan tri grupe eksperimentale. Grupi i kontrollit zhvilloi procesin mësimor në klasë tradicionale, pra duke mos përdorur asnjë lloj anotimi, ndërkaq tri grupet eksperimentale zhvilluan procesin mësimor në ambient digjital, respektivisht në laboratorin kompjuterik të shkollës, sipas kushteve të ndryshme të anotimit hipermedial. Grupi i parë eksperimental shfrytëzoi definicionin në gjuhën e parë, respektivisht përkthimet kontekstuale në shqipe gjatë procesit të leximit të teksteve në anglishte. Grupi i dytë eksperimental shfrytëzoi anotimin e dyfishtë, respektivisht definicionin në anglishte me audio anotim për fjalët e targetuara. Ndërsa, grupi i tretë eksperimental shfrytëzoi anotimin e dyfishtë, gjegjësisht definicionin kontekstual në anglishte të shoqëruar me imazh/pikturë. Studimi u bazua në metodologji kuantitative deduktive, përzgjedhje kjo e cila u diktua nga natyra e hulumtimit dhe e pyetjeve kërkimore të shtruar. Në mënyrë më specifike, u shfrytëzua diseni kuazi-eksperimental në mes të subjekteve me paratestim dhe pastestim të menjëhershëm dhe të vonuar. Kjo paradigmë kërkimore shkencore u respektua në përpikëri në të gjitha fazat e studimit. Të dhënat u mblodhën duke shfrytëzuar disa instrumente (shih kapitullin e metodologjisë). Analiza dhe interpretimi i rezultateve treguan vërtetim të pjesshëm të hipotezës kryesore, ndërsa konfirmime të plota për hipotezat e tjera. Nuk u vërejt ndonjë dallim domethënës statistikor në mes të grupeve eksperimentale dhe atij të kontrollit sa i

përket të kuptuarit e të lexuarit, ndërkaq dallime të rëndësishme statistikore u gjetën në matjet për mësimin rastësor të vokabularit, pra në favor të grupeve eksperimentale. Grupi i tretë eksperimental, i cili shfrytëzoi anotimin e dyfishtë me definicion në anglishte të shoqëruar me imazh/pikturë, tregoi rezultatet më të mira në të dy matjet e bëra, respektivisht për të kuptuarit e të lexuarit dhe për mësimin rastësor të vokabularit. I dyti për nga efikasiteti doli grupi i parë eksperimental, i cili shfrytëzoi anotimin përmes definicionit në gjuhën e parë, respektivisht përkthimit kontekstual në shqipe. Ndërkaq grupi i kontrollit dhe grupi i dytë eksperimental treguan rezultate më të ulëta në raport me grupin e parë dhe të tretë eksperimental. Gjetjet prodhojnë implikime pedagogjike, respektivisht indikacione se forma dhe modalitete të caktuara të anotimeve hipermediale kanë efikasitet të ndryshëm për qëllime të përmirësimit të të kuptuarit e të lexuarit dhe të mësimin rastësor të vokabularit në gjuhën e dytë. Andaj, kjo ndërmarrje studimore shkencore ishte një përpjeke unike për të gjetur e kuptuar më shumë se për kë dhe në çfarë rrethanash është efikase teknologjia në zhvillimin e kompetencave të caktuara gjuhësore.

Ky punim doktoral shtrihet në gjithsej gjashtë kapituj. Kapitulli i parë është ai i hyrjes në të cilin bëhet hyrja në temë dhe kontekst të studimit, pastaj ofrohet formulimin i problemit, rëndësia, arsyetimi, qëllimi, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit si dhe korniza teorike, shtrirja, limitet dhe përkufizimet e termave të rëndësishëm. Kapitulli i dytë i dedikohet shqyrtimit të literaturës i cili ndahet në tri pjesë. Në pjesën e parë bëhet shtjellimi i temave rreth fushës së CALL-it dhe aspekteve qendrore të tij. Pjesa e dytë i kushtohet aspektit teorik dhe praktik të leximit dhe të mësimin të vokabularit nga këndvështrime të ndryshme. Ndërsa pjesa e tretë i kushtohet studimeve specifike të mëhershme mbi leximin në gjuhën e dytë e, po ashtu, edhe të mësimin rastësor të vokabularit, kjo e fundit si produkt i procesit të parë. Kapitulli i tretë përbën metodologjinë e shfrytëzuar në punim duke prekur në mënyrë të detajuar çdo element të rëndësishëm në këtë pjesë aq të ndjeshme të hulumtimit empirik. Kapitulli i katërt paraqet rezultatet dhe analizën ku prezantohet çdo e dhënë e mbledhur për qëllime të këtij punimi. Tutje vazhdohet me kapitullin e pestë, pra atë të diskutimeve, në të cilin bëhet interpretimi i rezultateve dhe gjetjeve të hulumtimit në raport me kontributet shkencore paraprake, duke bërë kështu një lidhje në mes të teorisë, praktikës dhe hulumtimit, si tri shtylla kryesore të çdo fushe studimi. Dhe, krejt në fund, ofrohet kapitulli i gjashtë i cili fokusohet në përfundime, implikime pedagogjike dhe rekomandime për ndërmarrje të tjera studimore në të ardhmen.

Fjalët kyçe: leximi në gjuhën e dytë, anotim hipermedial, teknologji, pedagogji, nxënia e vokabularit

RESUME

Language teaching and learning in general and second language in particular, have been continuously studied, especially since the second half of the twentieth century, due to a great number of people moving from and to different countries, resulting in an increased need to learn foreign languages. The rapid pace of globalization processes along with technological developments, as well as the growing influence of English as a *lingua franca*, have resulted in an increased interest in studies and research in second/foreign language teaching and learning (Hinkel, 2011). Also, the increasing use of information technology in school and home environments has greatly expanded the possibilities of using technology in second language teaching (Hubbard and Levy, 2006). These developments have brought to the scientific discourse the phrase language and technology, which has now long served as an attractive field of inquiry. Hence, in light of these developments, undertaking this doctoral study in this specific field of knowledge, in a unique socio-cultural context, presents a modest as well as important contribution in attempting to find the most efficient approaches and methods towards the development of certain language skills.

In this regard, in the light of these developments and based on the demands of the time we are living in, this doctoral study was conceived in an attempt to investigate second language reading comprehension and incidental vocabulary learning in two different learning environments, i.e., the traditional classroom and the technology enhanced learning environment.

The development of second language reading competence occupies a central place in the field of Second Language Acquisition (SLA) and is a very important and complex component. Since its inception in the 1960s, the SLA has aimed to research and document how children and adults learn a second language, focusing on different linguistic, cognitive, social, contextual and psychological aspects (Abbhul and Mackey 2008). The emergence of CALL (Computer Assisted Language Learning) imposed a need in researching second language reading and vocabulary learning in a different environment and format. Reading and technology, according to Grabe (2009, p. 383), is

a complex field that is rapidly evolving in three main areas: “(a) the role of computers, instructional software, and other technological resources for technology-assisted reading instruction; (b) the growth of electronic genres and with technology resources; (c) the effectiveness of reading instruction involving new electronic genres and with technology resources”.

Therefore, in line with the calls of the scientific community and the trends of the development of the field on the one hand, as well as the perceptions and observations accumulated over the years about the challenges and problems presented during the process of teaching and learning of English as a second language, with a focus on reading and vocabulary learning on the other hand, this doctoral thesis came to light.

More specifically, this research aimed at finding whether second language reading comprehension and incidental vocabulary learning can be equally developed in two different teaching/learning environments, i.e., in the traditional classroom and the digital/technological environment. Also, the main goal was to find the most effective modality of hypermedia annotation in second language reading comprehension and incidental vocabulary learning. At the same time, the investigation aimed at finding whether digital learning environments are motivating for the development of these language skills. To achieve these goals, four groups of fifteen-year-old pupils were formed in a secondary school in Kosovo. One class of pupils formed the control group and the other three classes formed three experimental groups. The control group developed the learning process in the traditional classroom, i.e., without using any kind of annotations, while the three experimental groups learned in a digital environment, respectively in the school computer laboratory, under different hypermedia annotation conditions. The first experimental group used the definition in the first language, respectively the contextual translations in Albanian during the process of reading the texts in English. The second experimental group used dual annotations, respectively the English definition with audio annotation for the targeted words. Whereas, the third experimental group used the dual annotations, respectively the contextual definition in English accompanied by image/picture. The study was based on quantitative deductive methodology, an approach which was dictated by the nature of the study and the research questions posed. More specifically, the study employed a quasi-experimental between-subjects design with immediate and delayed post-tests. This scientific research paradigm was strictly followed and tightly controlled at all stages of the study. Data were collected using several instruments (see methodology chapter). The analysis and interpretation of the results showed partial confirmation

of the main hypothesis while full confirmations for the other hypotheses. No statistically significant differences were observed between the experimental and control groups in terms of reading comprehension, while statistically significant differences were found in the measurements for incidental vocabulary learning in favor of the experimental groups.

The third experimental group, which used dual annotations with English definition accompanied by image/picture, showed the best results in both reading comprehension and incidental vocabulary learning. The second in terms of efficiency was the first experimental group, which used annotations through definition in the first language, i.e., contextual translation into Albanian. Meanwhile, the control group and the second experimental group showed lower results compared to the first and third experimental groups. The findings provide pedagogical implications as well as indications that certain forms and modalities of hypermedia annotations have different efficacy in improving second language reading comprehension and incidental vocabulary learning. Therefore, this scientific research endeavor presented a unique effort in an attempt to find and understand more about for who and under what conditions is technology effective in developing certain language competencies. This doctoral dissertation consists of six chapters. The first chapter is the introduction which introduces the topic and context of the study, then provides the research problem, importance, rationale, purpose, research questions and study hypotheses as well as the theoretical framework, scope, limitations and definitions of key terms. The second chapter is dedicated to the review of the literature which is divided into three parts. The first part deals with the topics around the field of CALL and its central aspects. The second part is devoted to the theoretical and practical aspect of reading and vocabulary learning from different perspectives. While the third part is devoted to previous specific studies on second language reading and incidental vocabulary learning, the latter as a by-product of reading activity. The third chapter is dedicated to methodology used in the paper, describing into details every important element in this very sensitive part of empirical research journey. The fourth chapter presents the results and analysis where each data collected for the purposes of this paper is presented. Next comes the fifth chapter which is dedicated to discussions in which the interpretation of research results and findings in relation to previous scientific contributions is made, thus making a connection with theory, practice and research as the three main pillars of each field of study. And finally, the sixth chapter is presented and focuses on conclusions, pedagogical implications and recommendations for future research directions.

Keywords: second language reading, hypermedia annotation, technology, pedagogy, vocabulary learning